

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI MËSIMOR
LËNDA:GJUHË ANGLEZE
(klasa e shtatë)

Tiranë, 2005

HYRJE

Programi i gjuhës angleze për klasën e 7-të synon të përforcojë, të zgjerojë dhe të thellojë njohuritë e fituara në ciklin fillor dhe në klasën IV të arsimit të detyruar 9-vjeçar. Gjuha angleze shërben për formimin e përgjithshëm të nxënësve nga ana gjuhësore, kulturore dhe intelektuale. Ky nivel shton mundësitë që nxënësit të shprehën më mirë, duke zhvilluar më tej të katër aftësitë për t'u përballuar kësisoj më shkëmbimet në gjuhët e huaja. Të mësuarit e gjuhës angleze në këtë nivel shkollimi shërben edhe për të mësuar nxënësit të respektojnë të tjerët, si edhe për të qenë tolerantë ndaj mendimeve dhe kulturave të vendeve anglofolëse. Niveli gjuhësor rritet në mënyrë spirale, duke përsëritur çka është zhvilluar në ciklet e mëparshme dhe duke nxënë njohuri të reja në mënyrë të përshkallëzuar.

Synimet dhe objektivat e parshtuar në këtë kurrikul ndërtohen mbi bazën e programimit për klasat pararendëse, duke riparë ato në shërbim të programit të ri në të cilin hyjnë nxënësit.

Kurrikula e këtij niveli mban parasysh si grup-moshën e nxënësve, ashtu dhe karakteristikat e tyre përkatëse. Në të pëfshihen tema, objektiva, akte dhe funksione komunikuese që jo vetëm lidhen me interesat e tyre moshore, por edhe nxitin interesin dhe zgjojnë kureshtjen e tyre.

SYNIME EDUKATIVE DHE OBJEKTIVA DIDAKTIKE

Pëvetësimi i gjuhëve të huaja, në përgjithësi, dhe të gjuhës angleze, në veçanti, ndihmon në nxitjen e përgjegjësive të nxënësve dhe mësuesve për t'iu përgjigjur kërkesave për të qenë qytetar evropian me të gjitha të drejtat.

Kjo realizohet duke pasur parasysh se gjuha është :

- mjet i të menduarit (mjet për kryerjen e një sërë operacionesh mendore);
- mjet për të vendosur marrëdhënie shoqërore;
- mjet i shprehjes së mendimeve, të ndjenjave dhe gjendjes shpirtërore;
- mjet për shprehjen e kulturës (duke kuptuar edhe vështrimin historik, shoqëror e mjedisor), të rritë mundësitë që u jep shkolla nxënësve për zhvillimin e kompetencave gjuhësore, ndergjegjësimimin e tyre ndaj kulturave të tjera.

Synimet edukative

Të mësuarit e gjuhës angleze në klasën e 7-të ka këto synime edukative:

*të zhvillojë aftësitë gjuhësore të nxënësve, të cilat ndihmojnë formimin e përgjithshëm të tyre, si dhe t'i aftësojë ata të përdorin gjuhën për qëllime praktike. Konteksti gjuhësor jep mundësi për modele të të sjellurit në situata të caktuara mësimore.

*t'i familjarizojë nxënësit me aspektet dhe praktikat kulturore të vendeve anglishtfolëse. Kjo do të mundësojë zgjerimin e hapësirave formuese, kulturore dhe njohëse të personalitetit të nxënësit, duke ndihmuar kësisoj në formimin e personalitetit të tij, si dhe në përfshirjen e tij në ndërveprim sociokulturor.

*t'i mundësojë nxënësit të ndërtojnë punën në mënyrë të pavaruar, si dhe të përdorin strategji të të mësuarit për t'i bërë ata sa më krijues.

*t'i aftësojë nxënësit të përdorin teknika për të punuar dhe për të bashkëpunuar.

Objektiva didaktikë

Të mësuarit e gjuhës angleze në këtë nivel shkollor bazohet te këto objektiva didaktikë të të mësuarit:

1. Vendosja e nxënësit në qendër të vëmendjes. Nxënësit mësojnë më mirë atëherë kur njohuritë e reja lidhen drejtpërdrejt me ta, me jetën dhe përvojat e tyre jetësore. Kurrikula/programi mban parasysh nxënësin, njohuritë e tij, aftësitë e grup-moshës, interesat, talentin dhe përvojat vetjake.

2. Krijimi i mjedisit të të nxënës. Krijimi i një mjedisi shkollor fizik, emocional, sfidues dhe jofrenues për procesin mësimor, i një mjedisi në të cilin nxënësi ndjehet i qetë, siguron të mësuarit e frutshëm. Kjo arrihet kur menaxhimi dhe organizimi i veprimtarive të të nxënës që zhvillohen gjatë mësimin, shërben për të ruajtur vëmendjen, interesin dhe përfshirjen e nxënësve në mësim.

3. Organizimi i klasës. Organizimi i klasës është i zhdërvjelltë, mundëson punën në grupe dhe nxit lirshmërinë e nxënësve. Për të kuptuar qëllimin që përmban tema, nxënësit i krijohen mundësi apo lehtësi për të eksploruar në gjuhë, për të eksperimentuar në të, për ta përdorur atë në përputhje me nevojat e tij. Atmosfera e klasës është mbështetje dhe respekt për përgjigjen e nxënësit si nga mësuesi, ashtu edhe nga nxënësit e tjerë. Nxënësi ndërkohë mëson edhe nga shokët e tij. Herë pas here punon në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë për zgjidhjen e një problemi. Kështu, në secilën orë mësimi, mësuesi përdor mënyra të ndryshme të organizimit të klasës që krijojnë e ruajnë një mjedis mbështetës dhe rrisin motivimin e nxënësve.

4. Të mësuarit bashkëveprues/kooperues. Të folurit e rrjedhshëm varet nga bashkëveprimi i gjerë social, prandaj nxënësit gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh nxiten të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur me njëri-tjetrin e për të zhvilluar tek ta shkathtësi sociale. Njëherazi edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe ka edhe disa përparësi të tjera, si:

- a) ndihmon në shoqërizimin e nxënësve, i bën ata bashkëveprues me njëri-tjetrit ashtu dhe me mësuesit;
- b) nxit tolerancën ndaj mendimit të tjetrit;
- c) inicicion në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

5. Përdorimi i gjuhës në klasë. Gjuha angleze është mbizotëruese gjatë orës së mësimin. Mësuesi që është nxitësi dhe mbështetësi kryesor i përdorimit të gjuhës angleze në klasë, minimizon sa të jetë e mundshme përdorimin e gjuhës amtare.

6. Të mësuarit e gramatikës. Nevojat e veçanta për komunikim mbështeten në gramatikën komunikuese. Nxënësit mësojnë gramatikën në shërbim të funksioneve komunikuese. Në këtë nivel jepet një sasi e vogël rregullash gramatikore për t'u mësuar, gjithmonë në mënyrë të tillë që nxënësit të mund të përdorin format gramatikore për këtë

qëllim. Gramatika jepet dhe mësohet në mënyrë induktive. Nxënësit, gjatë të gjithë procesit të nxënies, ekspozohen ndaj dukurive të reja gramatikore nëpërmjet materialeve autentike.

7. Qortimi i gabimeve. Gabimet që nxënësi bën gjatë të shprehurit, duhet të qortohen por kjo në kohën dhe vendin e duhur. Vërejtjet, udhëzimet dhe qortimet e mësuesit, të shokëve ose dhe të vetë nxënësit ndihmojnë për të nxitur vetëbesimin dhe vetërespektin e nxënësit. Qortimi pa kriter mund të çojë në frenimin e nisëativës, heqjen e dëshirës për të folur, demotivimin, madje mund të rrezikojë edhe ecurinë e mëtejshme të mësimit. Mësuesi ndërhyt me takt dhe, duke përdorur forma të larmishme, qorton më shpesh kur nxënësit praktikojnë strukturat gramatikore dhe më rrallë kur nxënësit janë duke punuar në grup, kur janë duke debatuar apo duke diskutuar për tema të ndryshme.

8. Vazhdimësia dhe rimarrja. Një kurrikul efektiv për mësimin e gjuës angleze njih rolin e vazhdimsisë dhe të riciklimit gjatë të mësuarit. Progresi kalon nga e thjeshta në të vështirën, nga konkretja në abstrakte. Studimet dhe eksperimentimet kanë provuar se zakonisht për të përvetësuar elementet e reja gjuhësore, nxënësi ka nevojë të ekspozohet ndaj tyre shtatë herë, në shtatë kontekste të ndryshme. Pra rimarrja e njohurive është e domosdoshme.

VLERËSIMI

Kontrolli dhe vlerësimi i përparimit të nxënësve nxit përparimin e mëtejshëm të tyre dhe krijon harmonizimin në kalimin e një veprimtarie në tjetrën. Mësuesi kujdeset për krijimin e një klime të qetë ku nxënësi nxitet dhe nuk tensinohet nga frika e vlerësimit. Vërejtjet dhe udhëzimet e mësuesit ndihmojnë për të rritur vetëbesimin dhe vetërespektin. Vlerësimi i punës së nxënësit gjatë dhe pas mësimit është konstruktiv dhe në kohë të përshtatshme. Mësuesi përcakton standarde të pritshme për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga ndryshimet e tyre individuale, emotive, kulturore dhe gjuhësore. Vlerësimi bëhet në mënyrë sistematike dhe ndërthuret gjatë të gjithë procesit të mësimnxënies dhe të mësimnxënies.

Mësuesit realizojnë ballafaqimin e nivelit të përparimit individual e kolektiv, duke mbledhur vazhdimisht informacion për zhvillimin dhe asimilimin e njohurive dhe të aftësive. Ata shënojnë dhe vlerësojnë përparimin sistematik të nxënësve nëpërmjet vëzhgimeve, pyetjeve, testeve dhe detyrave me shkrim në shtëpi e klasë dhe sigurohen nëse nxënësit vazhdojnë të bëjnë përparime të dukshme në përvetësimin e dijeve, të shprehive të të kuptuarit dhe të të shprehurit. Mësuesit monitorojnë dhe qortojnë detyrat duke përcaktuar objektiva të qartë.

Mësuesi nëpërmjet formave të ndryshme të vlerësimit siguron që nxënësit të përfitojnë dhe të konsolidojnë njohuritë, aftësitë dhe të kuptuarit e të shprehurit për njohuritë e përfshira në këtë program.

Format e ndryshme e të larmishme të vlerësimit u krijojnë mundësi nxënësve për të konsoliduar njohuritë e tyre si në klasë, ashtu edhe në shtëpi, duke u dhënë detyra të studiuara specifike me objektiva të qartë që përforcojnë dhe çojnë më tej njohuritë e fituara.

Mësuesi i kushton vëmendje gabimeve dhe jep ndihmë në qortimin e tyre. Kontrolli gojor, megjithë karakterin e vetë subjektiv, mbetet një element i rëndësishëm i

vlerësimit të arritjeve. Kontrolli me shkrim jep një informacion më të plotë për arritjet e tyre.

Testet diagnostikuese, të arritjeve, të progresit, të përcaktimit të niveleve, si edhe kuizet të jenë realiste, me objektiva të qarta e të matshëm.

Për të realizuar një vlerësim sa më objektiv dhe motivues, mund të përdoren tipa të tillë të ushtrimeve: përsëritje, dialogje të drejtuara dhe të hapura, intervista, simulime, plotësime, pyetje të tipit “E saktë apo e gabuar”, pyetje të hapura, pyetje alternative, plotësime hartash, rrjeta semantike, diktime, riformulime fjalish, plotësim fjalish, zëvendësime fjalësh, ndërtim fjalish, qortime gabimesh etj.

Mësuesi njëherazi i përdor këto vlerësime për të përmirësuar aspekte të ndryshme të punës së tij, shikon në mënyrë kritike metodat e tij të mësimdhënies dhe vepron po në mënyrë kritike për të përmirësuar frytshmërinë e tyre.

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në mësimin e gjuhës angleze. Nxënësit vlerësojnë nga ana e tyre zotërimin e objektivave dhe të standardeve të përshkruara në kurrikul. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin progresiv të tyre. Rëndësia e vetëvlerësimit nxit të mësuarit e pavarur gjatë gjithë jetës dhe i ndërgjegjëson nxënësit të kuptojnë më mirë problemet e të mësuarit.

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Vetëvlerësimi njëherazi mund të konsiderohet edhe si aspekt problematik që shtron pyetje të tilla: “ Si është e mundur që nxënësit të vlerësojnë vetvehten?”, “A kanë ata njohuri të mjaftueshme?”, “A mund të jenë objektivë?”, “A mund të jetë vetëvlerësimi i besueshëm?” etj . Të gjitha këto për vetë faktin që vetëvlerësimi nuk është pjesë e traditës sonë arsimore. Vetëvlerësimi është i rëndësishëm sepse lidhet me forma të tjera të vlerësimit dhe varet nga marrëdhëniet e drejta që vendosen ndërmjet tyre, në të cilat subjekt është vetë nxënësi.

Në procesin e mësimit të gjuhëve të huaja vetëvlerësimi mund të përqendrohet në tri aspekte kryesore:

1. Në procesin e mësimit, që do të thotë vlerësimin e progresit të tyre, nivelin e arritur në secilin rast dhe suksesin ose mosesuksesin në realizimin e detyrave dhe objektiva të caktuar.
2. Në aftësitë e tyre komunikuese.
3. Në zotërimin e gjuhës, pra në leksikon që zotëron, në strukturat gjuhësore dhe mënyrën si e artikulon gjuhën.

PËRSHKRIMI I NIVELEVE TË KATËR AFTËSIVE GJUHËSORE

Zhvillimi i aftësive gjuhësore realizohet i integruar gjatë të gjithë procesit mësimor. Përshkrimi i niveleve nuk mund të merret i veçuar. Ai shqyrtohet në kuadrin e përshkrimit të niveleve të arritura deri në fund të klasës së gjashtë. Mësuesi mbështetet në përshkrimin e niveleve për të ndërtuar strategjitë dhe teknikat e vlerësimit si të nxënësit, ashtu edhe të vetat. Njëherazi ai i përdor ato për të përcaktuar shkallën e përparimit, të përvetësimit dhe të arritjeve të nxënësve.

Në fund të klasës së shtatë nxënësit:

- U përgjigjen dhe formojnë fjali dëftore dhe urdhërore të thjeshta të tilla, si: përshëndetje, paraqitje, leje etj.
- Shprehin qëndrimet e tyre, reagimet, sjelljet duke përdorur shprehje të shkurtra dhe të thjeshta.
- Shprehin pëlqimin ose mospëlqimin për diçka.
- Përshkruajë njerëzit, vendet, sendet, ngjarjet duke përdorur shprehje të ngulitura të shkurtra.
- Marrin dhe japin informacion për temat të njohura.
- Shprehin nevojat e tyre personale më elementare
- Në aspektin gjuhësor bëjnë dallimin ndërmjet pjesëve kryesore të ligjëratës, si dhe fjalorit bazë.

Përshkrimi i nivelit për dëgjimin.

1. Nxënësi kupton urdhrat dhe reagon ndaj tyre.
2. Nxënësi kupton fraza, fjali dhe shprehje që lidhen me fushat e interesit të tij, informacione për vehten, familjen, shokët, vendbanimin, klasën dhe shkollë .
3. Nxënësi kupton dhe reagon ndaj fjalive të thjeshta të gjuhës së folur, duke dalluar fjalë dhe shprehje të njohura të frekuencës së lartë ku flitet ngadalë dhe qartë. Njëherazi nxënësit janë të aftë të kërkojnë sqarime ku nuk kuptojnë diçka.
4. Nxënësi tregon se kupton dhe reagon ndaj dialogjeve dhe mesazheve të reja të shprehura në një gjuhë të thjeshtë dhe kryesisht çështjeve kryesore dhe hollësive të rëndësishme.
5. Nxënësi tregon se me anë të përsëritjes, gjesteve dhe elementeve të tjera vizuale kupton rrëfime dhe përshkrime të njohura të shprehura me një gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe me ritëm normal që ka lidhje me ngjarje të kaluara, të tashme dhe të ardhme.
6. Nxënësi kap thelbin në mesazhe, lajme të shkurtra, të thjeshta në radio, televizion duke reaguar ndaj pikave kryesore dhe të rëndësishme.

Përshkrimi i nivelit për të folurin

1. Nxënësi përgjigjet me shqiptim të qartë e të kuptueshëm duke përdorur struktura dhe fjalor të thjeshtë të përdorimit të përditshëm e të mësuara më përpara.
2. Nxënësi merr pjesë në dialogje me pyetje të thjeshta dhe përgjigje të shkurtra për atë çka përjeton duke shprehur ndjenjat, dëshirat apo parapëlqimet e tij.
3. Nxënësi merr pjesë në skenare të shkurtra të parapërgatitura, që bazohen në bashkëbisedime të ndërhuara me fraza të ngulitura më parë, të cilat përdoren për të kërkuar dhe për të përcjellë informacione për situata të kaluara, aktuale ose të ardhshme.
4. Nxënësi përshkruan thjesht me shqiptim të saktë, leksik dhe struktura të njohura, persona, objekte, si edhe veprimtari të tij të përditshme.
5. Nxënësi u përgjigjet thjesht dhe shkurt pyetjeve që kanë lidhje me tekste të lexuara apo të dëgjura në procesin mësimor.
6. Nxënësi merr pjesë në biseda të shkurtra duke kërkuar dhe duke përcjellë informacione, duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve për përjetime të kaluara aktuale dhe plane të ardhshme.

7. Nxënësi mund të përdorë një sërë frazash e fjalish për të përshkruar në gjuhë të thjeshtë familjen e tij, shokët, shoqet dhe persona të tjerë, arsimimin e tij, si dhe situatën e tij aktuale në shkollë.

Aspekte fonetike

Krahas riciklimit të dukurive fonetike e fonologjike që mundësojnë njohjen dhe aftësimin për të perceptuar dhe për të realizuar shqiptim dhe theks të saktë të fjalisë, në klasën e shtatë i kushtohet vëmendje e vecantë edhe dukurive të mëposhtme:

1. Intonacionit të fjalive urdhërore, pohore dhe mohore:

Example: Ring me up as soon as you can.

Don't look at your friends answer.

2. Fjali që shprehin mirësjellje, kërkesë, lutje:

Example: Can you repeat it again please?

Could you read it once more?

3. Fjali pyetëse me përsëritje të foljes ndihmëse:

Example: You speak English, don't you?

You read the book, didn't you?

You are a pupil of the seventh grade, aren't you?

4. Fjali që përmbajnë numërim idesh:

Example: He gets up at 7 and has his breakfast at 8.

5. Fjali thirrrore:

Example: What a nice story.

6. Fjali që shprehin kontraste:

Example: He likes history but I don't.

7. Theksi i fjalëve shumërrokëshe.

8. Shqiptimi i disa parafjalëve/ndajfoljeve:

Example: Where are you going to? (tu),

I am going to London (tə),

I want bread and (ən) butter and (ænd) cake.

9. Shqiptimi i formave të parregullta të disa foljeve:

Example: read(present) and read (past),

Run (present) and ran (past) and run (participle):

Përshkrimi i nivelit për të lexuarit

* Nxënësi dallon informacionet kryesore në përmbledhjen e lajmeve apo të artikujve të thjeshtë në gazeta, të shkruara, të ilustruara dhe të strukturuar qartë, ku emrat dhe shifrat luajnë një rol të rëndësishëm.

*Kupton një korrespondencë apo mesazh të thjeshtë të shkruar nga shokët me dorë ose me kompiuter, ku lihet takimi, vendi dhe ora për të shkuar në kinema, ndeshje etj.

*Orientohet të gjejë nëpër fletëpalosje informacionet e dëshiruara për veprimtari jashtëshkollore, si: shfaqje, ekspozita, muze etj.

*Kupton tekste që përmbajnë kryesisht material të lidhura me jetën shkollore apo veprimtarinë e interesat përkatës të moshës, të shprehura në gjuhë të përdorimit të përditshëm.

Pershkrimi i nivelit për të shkruarit

*Përshkruan një ngjarje me fjali të thjeshta dhe tregon çfarë ka ndodhur, kur dhe ku, p.sh., për një festë, një aksident etj.

* Përdor lidhëzat më të rëndësishme për të treguar rëndin kronologjik të ngjarjeve (në fillim, më pas, më vonë, në fund).

*Shpehet me fjali e shprehje të thjeshta për aspektet e jetës së përditshme, si: për vendin ku banon, për shkollën, familjen etj.

*Shkruan sipas drejtshkrimit fjali të shkurtra që janë pjesë e fjalorit të tij.

*Shkruan tekste të thjeshta duke gabuar herë pas here, p.sh., në përdorimin e kohëve të foljes, ndonëse e shpreh qartë atë çfarë dëshiron.

*Mban shënime të shkurtra, të thjeshta dhe dergon mesazhe për nevoja të çastit, p.sh., për drejtimin, si të mbërrijë diku, bën listë për sendet që do të blejë apo veprimet që do të kryej gjatë ditës.

Fjalori

Programi për klasën e shtatë parashikon një fjalor aktiv prej rreth 600-650 njësisish leksikore. Fjalori bazë i mësuar në nivelet e mëparshme do të riciklohet e do të pasurohet në vartësi të temave që do të trajtohen.

Leksiku i parashikuar në këtë nivel lidhet me tema të tilla, si: rregullat e përgjegjësitë në shkollë, rutina e përditshme, oraret, sportet, festat, blerjet, ndotja, filmat etj.

Ai, gjithashtu, trajtohet i lidhur ngushtë me aspektet pedagogjike të mësimdhënies, si dhe me aspektet gramatikore.

Përveçse ndiqen parimet statistikore në lidhje me leksikun, duke zgjedhur fjalë me përdorim të lartë, ai trajtohet e mësohet në shërbim të veprimtarisë komunikuese e në përputhje me kërkesat e interesat e nxënësve të përfshirë në këtë process. Prandaj fjalori nuk planifikohet paraprakisht.

Programi sintetik

35	x	2orë	=	70 orë
Përsëritje në fillim të vitit				4 orë
Mësime të reja				54 orë
Përsëritje gjatë vitit				4 orë
Detyra me shkrim				4 orë
Lexime e biseda të lira				4 orë

TOPICS

1. EVERY DAY LIFE

Domestic routine

Shopping (prices & sales)

Leisure activities (birthday parties, games, school trips)

Rules at home

Health education (diet and fitness)

2.SCHOOL LIFE

School rules, responsibilities and duties
Maths: Numbers, fractions, percentages
School day and study time

3.PERSONAL AND SOCIAL LIFE

Hobbies and interests
Services (doctor, dentist, hospital)
Friendship (conflict resolutions)
Biology: Muscles in your body
My family (rules and responsibilities)

4.WORLD AROUND US

The world of sport
Environment: Traffic and pollution
Festivals and holidays
My favourite season
Geography: Countries of the World

5.WORLD OF COMMUNICATION

Radio and television (favourite programs)
Favourite films (Walt Disney)
Sending and receiving messages (letters, faxes, e-mail)
Formimi i aftësive komunikuese është I lidhur me nevojat e nxënësve për ta përdorur gjuhën në situata imediate si shprehje ndjenjash, opinionesh, apo për t'u orientuar në lidhje me vendin, kohën e takimit etj.
Aktet komunikuese apo funksionet janë të lidhura ngushtë me temat e trajtuara në këtë nivel

COMMUNICATIVE ACTS / FUNCTIONS

Making polite requests

Could you close the door, please ?

Giving and accepting invitations

Would you like to dance? Yes, I would love to.

No, thank you.

Making offers

Would you like a coke?

Expressing wishes and preferences

I'd like to go to America

I'd prefer a coke

I'd rather go to France
 Talking about possession
 Whose jumper is this?
 Talking about experiences
 Have you seen.....?
 Have you ever been to.....?
 Asking permission
 Can I go to the disco?
 Talking about obligation
 We have to wear a uniform.
 Talking about permission
 My parents let me go to parties
 I am not allowed to travel on my own.
 Asking for help
 Can you send me more information about it?
 Talking about decisions, future plans
 I want to go sight seeing.
 I have decided to become a doctor
 Asking for agreement
 It's cold today, isn't it ?
 Giving instructions
 Don't forget to do your homework
 Don't worry
 Describing past events
 What did you do?
 I went to

Expressing likes and dislikes
 I like playing football
 I hate queuing

Strukturat gramatikore që trajtohen në klasën e shtatë, riciklojnë ato të mëparshmet, gjithashtu trajtojnë njësi të reja gramatikore duke shtuar bagazhin e njohurive të cilat janë të lidhura ngushtë me temat që trajtohen në këtë nivel. Theksohet se trajtimi i strukturave bëhet jo i shkëputur si njësi më vete, por është në shërbim të komunikimit në situatë reale. Si e tillë ajo kërkon përdorimin e llojeve të ndryshme të ndërveprimit në klasë, si puna dyshe apo me grupe.

LANGUAGE STRUCTURES

Simple past of irregular verbs

 Could, brought, cut, began, became, bought, fell, felt, knew etc.

Sample past with ago

 He left a few minutes ago

Quantifiers: Countable and uncountable nouns (how much? Many? A few, a little, a lot of

 How much milk is there...? There is a little milk.

How many students are there? There are many students

Comparative forms of adjectives showing equality (as...as)
 She is as old as my sister.

Superlative forms of adjectives
 She is the most intelligent student in our class

Too
 The tea is too hot. I can't drink it

Present perfect tense (never, ever, yet)
 Have you ever been to London?
 I have never seen that film.
 He hasn't come yet

Past simple VS present perfect
 He has gone to bed
 He went to bed ten minutes ago

Modals- Have to (affirmative, interrogative, negative)
 Do you have to do any housework?
 Yes, I do. I have to clean my room everyday

Possesive pronouns (mine, yours etc)
 Whose is this sweater? Is it yours, Judy ?

Verb patterns (verbs + ing & verbs + infinitive)
 Like doing, like to do, stop to do, enjoy doing, want to do,
 prefer doing, decide to do, hate doing, offer to do, let sb do, allow to do

Question tags (present and past tenses)
 English is easy, isn't it?
 He isn't Spanish, is he?
 You went to Roma, didn't you?
 They didn't come in time, did they?

Partitives with countable and uncountable nouns:
 A bar of soap, a packet of tea, a loaf of bread, a can of soda, a jar of jam

Tense review: Past simple
 Present simple
 Past continuous

KRITERET PËR HARTIMIN E TEKSTIT

Teksti “Gjuha angleze-7” për shkollat nëntëvjeçare të jetë rrjedhojë e këtij programi. Ai të jetë i përbërë nga 2 pjesë, nga libri i nxënësit dhe fletorja e punës, si dhe mundësisht kasetë për të zhvilluar aspektin e të dëgjuarit.

Për hartimin e tekstit “Gjuha angleze-7” është mirë të realizohen dhe të respektohen parimet dhe kriteret e mëposhtme:

1. Të respektohet programi i hartuar për këtë klasë.
2. Zgjedhja dhe seleksionimi i metodës të bëhet për një publik dhe mjedis specifik.
3. Autorët janë të lirë të vendosin temat atje ku ato mundësojnë përshtatje me qëllimet mësimore, gjuhësore, strukturore, kulturore dhe ndërthurjen tyre.
4. Teksti të jetë i ndarë me njësi didaktike dhe me linja të caktuara që realizojnë objektiva dhe qëllime të larmishme mësimore. Materiali të jetë tërheqës dhe me ngjyra.

Parapëlqehet që aparati pedagogjik i çdo mësimi të shoqërohet me rubrikat përkatëse, të cilat pasqyrojnë integrimin e katër aftësive gjuhësore duke shmangur format tradicionale. Ushtrimet për të zhvilluar aftësi të tilla, si: të lexuarit, të folurit, të shkruarit e të degjuarit, të jenë pjesë përbërëse e këtij teksti të integruara në vetvete dhe në çdo orë mësimi si në pjesën teorike të temave të veçanta, ashtu edhe në pjesën praktike.

Parimi didaktik i rimarrjes së njohurive të jetë pjesë e mësimëve që do të përbëjnë këtë tekst, me qëllim lidhjen dhe përforsimin e njohurive të dhëna në mësimet e mëparshme. Këshillohet një mësim përsëritës pas çdo cikli prej 4 mësimesh të reja.

Teksti “Gjuha angleze-7” të hartohet në mënyrë të tillë që të mundësojë vendosjen e nxënësit në qendër të procesit mësimor, të sigurojë baraspeshë ndërmjet veprimtarive individuale apo kolektive dhe t’i përshtatet zhvillimit emocional të nxënësve.

Teksti të përmbajë punë me shkrim si pjesë përbërëse të çdo ore mësimore. Këto të jenë veprimtari që t’i përfshijnë nxënësit në veprimtari të gjera zbatuese dhe shkallë-shkallë për të kaluar edhe në veprimtari krijuese.

Ushtrimet dhe format e punës që lidhen me mësimdhënien ndërvepruese, të jenë të dukshme në strukturën e aparatit pedagogjik të këtij teksti. Propozohen veprimtari ludike (të lidhura me lojën) që nxënësit të mësohen të bëjnë vetë, të prekin, të ndjejnë, të vëzhgojnë, të shijojnë, të eksperimentojnë etj. Propozohen një sërë veprimtarish të larmishme që ngjallin imagjinatën dhe krijimtarinë e nxënësve dhe, gjithashtu, të përshtatshme për të gjitha nivelet.

Teksti “Gjuha angleze-7” të jetë me katër ngjyra.

Teksti të ketë 150 faqe A4

Formati të jetë 260 x 200 mm.